

Rezultatet e anketës, përditësim mbi ecurinë dhe plani i punës për vitin 2021 i Komunitetit të Praktikës për Edukimin (KPE)

Ekipi i KPE-së, PULSAR
prill 2021



CFRR >>
Centre for Financial
Reporting Reform



Public Sector Accounting and Reporting Program

PULSAR Program is co-funded by:



 Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Confederation

Federal Department of Economic Affairs,
Education and Research EAER
State Secretariat for Economic Affairs SECO

Informacion i përgjithshëm për seancën

Rezultatet e anketës

Përditësim mbi ecurinë e edukimit
për kontabilitetin në sektorin publik

Plani i Punës 2021

Qëllimet e kryerjes së anketës:


1. Përditësimi i statusit të vendeve pjesëmarrëse sa i takon zgjerimit të trajnimit të trajnuesve për SNKSP-të
2. Identifikimi i përparësive kryesore të mbështetjes së mëtejshme brenda KPE-së së programit PULSAR



Numri i përgjigjeve të marra:




PULSAR Member Countries




Vendi/ Gjithsej	23
Shqipëria	1
Armenia	1
Azerbajxhani	2
Bjellorusia	2
Bosnja dhe Hercegovina	1
Kroacia	1
Gjeorgjia	4
Kosova	1
Maqedonia e Veriut	--
Moldavia	3
Mali i Zi	--
Serbia	1
Ukraina	6

Përfundimi i trajnimit të trajnuesve i shkallës 2 dhe planifikimi për zgjerimin




- Përfunduar TT shkalla 2
- Filluar ose planifikuar zgjerimin
- Nuk kanë planifikuar zgjerimin e programit të trajnimit
- Nuk ka informacion

Llojet e parapëlqyera të mbështetjes nga BB të nevojshme për zgjerimin e trajnimit të trajnuesve:




Sa shpesh duhen zhvilluar uebinaret e KPE-së




Temat kryesore me interes për zhvillimin e uebinareve të KPE PULSAR

Temat me interes



- Përgatitja e një programi mësimor model të bazuar në SNKSP-të për ofruesit e edukimit për kontabilitetin në sektorin publik
- Ndarja e përvojës së vendeve pjesëmarrëse të PULSAR-it lidhur me mbulimin e temave të përzgjedhura të KSP-së në kuadrin e edukimit
- Ndarja e përvojës së vendeve të BE-së në zbatimin e temave të lidhura me SNKSP-të në edukimin kontabël
- Uebinare të përbashkëta me KP-RF dhe diskutime në vijimësi brendapërbrenda KPE-së për temat përkatëse të edukimit kontabël

Instrumente që mund të ndihmonin në çuarjen përpara të edukimit kontabël në sektorin publik



Përfundime:

1. Pjesa më e madhe e vendeve pjesëmarrëse kanë ndërmarrë masa me synim zgjerimin e programit të trajnimit të trajnuesve për SNKSP-të. Disa vende janë në proces planifikimi të trajnimit ose përhapjes; por ecuria është ngadalësuar për shkak të pandemisë së COVID-19 dhe të kufizimeve përkatëse.
2. Ka një interes të fortë për të vijuar me ndarjen e përvojave të edukimit të KSP-së nga vendet anëtare të KPE PULSAR dhe praktikave të mira nga mbarë bota.



Përditësim mbi ecurinë e edukimit për kontabilitetin në sektorin publik

Katër seanca për trajnimin e trajnuesve për SNKSP-të janë zhvilluar në Vjenë, Tiranë, Sarajevë dhe Batum. 79 pjesëmarrës janë trajnuar nga ACCA dhe shkalla e kalimit të provimit në përfundim të kursit ishte 97%.

Anëtarëve të PULSAR-it u është dhënë kurs certifikimi online për SNKSP-të nga ACCA. Deri tani mbi 60 e kanë kaluar, ndërsa pjesëmarrësve të tjerë u është bërë zgjatje me 6 muaj e afatit për përfundimin e kursit.

Plani i Punës 2021

- Fuqizimi i bashkëpunimeve me institucionet strategjike që ofrojnë edukim të KSP-ve për të identifikuar partneritetet me vendet anëtare të PULSAR-it lidhur me sa vijon:
 - Kurse online për SNKSP për zgjerimin e programeve të trajnimit brenda vendit.
 - Materialet mësimore që përfshijnë raste studimore dhe udhëzues praktikë apo manual për trajnuesit e KSP-së.
 - Program mësimor/program lënde model të bazuar në SNKSP që mund të përdoret nga ofruesit e edukimit të KSP-së.
- Biseda ndëraktive online për të prezantuar shembujt e mirë të edukimit të KSP-së dhe zbatimin me sukses të SNKSP-ve.





Faleminderit!